



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 880/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Sheqir Mehmeti, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Sheqir Mehmeti, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjën ZL.Anr.880/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 10:45, nga Sheqir Mehmeti, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën pretendon se në vendvotimet VV nr. 1806e/01d, 1805e/01d, 1830e/02d, 1804e/01r, 1804e/02r, 1831e/02d, 1801x/01r, 1804x/02r, 1801x/03r, ka parregullsi

Në cilësi të provës si dëshmi ka bashkangjitur një deklaratë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe vlerësimit të shkresave në lëndë, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apel nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet 1806e/01d, 1805e/01d, 1830e/02d, 1804e/01r, 1804e/02r, 1831e/02d, 1801x/01r, 1804x/02r, 1801x/03r, dhe nuk i ka argumentuar me fakte pretendimet e tij lidhur me parregullsitë e pretenduara në ato vendvotime ashtu siç është paraparë në dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, siç është në rastin konkret, e refuzon apelin si të pabazuar.

Nga sa u tha me sipër duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.880/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Pralini



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*